



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 15.07.2016

Ref.: 641/16

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.02/2013, datë 16.01.2013), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 43-të, të mbajtur më 06 Korrik 2016, mori:

V E N D I M

- I. Riakreditohet BPrAL Kolegji "ISPE" në nivel institucional për periudhën pesë vjeçare, 1 tetor 2016 – 30 shtator 2021.
- II. Riakreditohen programet e studimit për periudhën tri vjeçare, 1 tetor 2016 – 30 shtator 2019:
 - Juridik, LLB, 240 ECTS, (maksimum 50 studentë për vit akademik);
 - Ekonomik, BA, 180 ECTS (me specializime: Banka, Financa, Kontabilitet; Marketing; Menaxhment dhe Informatikë; Ekonomiks), (maksimum 200 studentë për vit akademik);
 - Shkenca Politike, BA, 180 ECTS, (maksimum 50 studentë për vit akademik);
 - Studime të Sigurisë, BA, 180 ECTS, (maksimum 150 studentë për vit akademik).
- III. Nuk akreditohet programi i studimit:
 - Biznes dhe Menaxhment, MA, 120 ECTS.
- IV. Kuotat e caktuar më sipër për regjistrim e studentëve në programet e studimit, vlejné nga viti akademik 2017/2018.

- V. Obligohet BPrAL Kolegji "ISPE" që deri me 1 tetor 2016 në Agjencinë e Kosovës për Akreditim ta dorëzoj planin e rekrutimit të stafit akademik, për vitin akademik 2016/2017, për arsyeje të pensionimit të mundshëm të stafit, apo për çfarëdo arsyeje tjetër.
- VI. Obligohet BPrAL Kolegji "ISPE" që deri me datë 1 tetor 2016 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna në raportin final nga ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit.

A r s y e t i m i

BPrAL Kolegji "ISPE" ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), për riakreditim institucional dhe ri/akreditim të programeve të studimit me stafin akademik si në vijim:

| Nr. | Programi i studimit | Niveli | ECTS | Bartësit e Programit |
|-----|-----------------------|--------|------|---|
| 1 | Juridik | LLB | 240 | Bashkim Musliu; Sheherzada Murati, Faton Maloku |
| 2 | Ekonomik | BA | 180 | Agim Mamuti; Rozana Rushiti, Raman Ismajli |
| 3 | Shkenca Politike | BA | 180 | Asllan Hamiti, Arsim Rexhepi, Enver Bytyçi |
| 4 | Studime të Sigurisë | BA | 180 | Xhavit Shala, Bajram Yzeiraj, Besa Veseli |
| 5 | Biznes dhe Menaxhment | MA | 120 | Iva Zajmi, Florim Idrizi, Agron Rustemi |

AKA ka organizuar dy vizita në BPrAL Kolegji "ISPE". Vizita e parë është realizuar më 30.05.2016, me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Prof. Dr. Hans J. Giessmann; Mr. Luca Ciubotaru. Vizita e dytë është realizuar më 14.06.2016 me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Prof. Dr. Tiiu Paas; Prof. Dr. Ingeborg Mottl.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur me 06 korrik 2016 ka shqyrtuar aplikacionin e BPrAL Kolegji "ISPE", dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportin final nga ekspertët e cekur më sipër, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Në lidhje me programin e studimit Biznes dhe Menaxhment, MA, 120 ECTS, raporti i ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit, numëron këto vërejtje kryesore të cilat kanë qar në mos dhënien e rekomandimit për akreditim:

Raporti i Vet Vlerësimit i Kolegjit ISPE ka paraqitur të dhëna kontradiktore në lidhje me stafin akademik. Po ashtu të dhënat në lidhje me mbikëqyrësin e programit si dhe me përgjegjësit e programit janë sipas ekspertëve të paqarta. Sipas RVV-së, bartësi i programit është Dr. Izet Ibrahim i cili është mbikëqyrës në të njëjtën kohë edhe në programin BA Ekonomik. Sipas ekspertëve, përgatitja akademike dhe publikimet e tij nuk përshtaten plotësisht me fushën e ekonomisë, biznesit dhe menaxhmentit. Në anën tjetër, sipas informatave që ekspertët i kanë marrë gjatë vizitës së akreditimit, është bërë e ditur që bartës të programit janë Dr-s. Iva Zajmi, Florim Idrizi dhe Sadri Alija që sipas ekspertëve nuk kanë përgatitje akademike në fushën e biznesit dhe menaxhmentit.

Ekspertët kanë mësuar se Dr. Iva Zajmi është në të njëjtën kohë përgjegjëse edhe e programit Juridik/ LLB. Sipas ekspertëve çështja më kritike për implementimin dhe zhvillimin e një programi të ri master, i cili ka për qëllim që të pranojë 100 studentë të rinj, është përcaktimi i qartë i kompetencave dhe përgjegjësi të stafit akademik të cilët do të jenë përgjegjës për këtë program dhe të cilët kanë përgatitjet e nevojshme për ofrimin e programit. Prandaj sipas ekspertëve, pa zgjidhur njëherë problemet të cilat lidhen me përgjegjësitë dhe kualifikimet e stafit akademik, është e pamundshme implementimi i suksesshëm i programit master në Biznes dhe Menaxhment.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet kërkesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 126, pika 2 a, të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 02/L-28. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet këtij organi në afatin prej 30 ditëve siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën Administrative.

Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Vendimi iu dërgohet:

- BPrAL Kolegji "ISPE"
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.

Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë